



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

**Nr. 12**

**Datë: 22. 04. 2023. Ora: 11:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

**1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**3. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit operacional për ditën e zgjedhjeve, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Laposaviq dhe Zubin Potok, si dhe për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Laposaviq,

Shqyrtimi dhe miratimi plotësimeve të përbërjes së KVV-ve, për komunën e Laposaviqit dhe plotësimin me anëtar rezervë të KVV-ve për Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut.

Shqyrtimi dhe miratimi i Ekipeve Mobile për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut

#### 4. Të ndryshme !

---

##### **1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kryetari Radoniqi**, pasi paraqiti agjendën anëtarët e KQZ-së me vota unanime, miratuan rendin e ditës. Në z. Radoniqi, dha një mesazh për këtë proces të zgjedhjeve duke e shpjeguar faktin se çdo është gati për zgjedhjet, dhe në emër të KQZ-së, ftoi qytetarët të dalin në zgjedhje, pra ta shfrytëzojnë votën e tyre...

##### **2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**Burim Ahmetaj**, krye shëf i KQZ –së, tha se Sekretariati i ka bërë të gjitha përgatitjet dhe se, 13 QV janë alternative. Na raportet e divizioneve, atij shërbyes, ka rezultuar se 1 person ka qenë në qendrën e paraburgimit në Gjilan, 13 në Prishtinë, 1 në Pejë, në Mitrovicën e veriut 21 persona, në burgun e sigurisë së lartë 10 persona, dhe në qendrën korrektuese në Dubravë, 5 persona. Ai, e informoi KQZ-në, se sa persona gjenden në listat përkatëse nga këto komuna, dhe tha se ekipet mobile do ta kryejnë punën e tyre...

Ai, në fund tha se, sekretariati vepron edhe më tutje, fletëvotimet kanë arritur, dhe me materialin administrativ zgjedhorë, do të përcillet me kohë...

##### **3. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

###### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit operacional për ditën e zgjedhjeve, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq:

**Arianit Elshani**, tha se KOZ-i, ka takuar zyrtarët e KKZ-ve përgjegjës, dhe është diskutuar për çdo aktivitet, dhe detyrat që dalin. Mendojmë që janë bërë të gjitha përgatitjet, sipas planit. E kemi shqyrtuar edhe planin, dhe ne rekomandojmë për miratim. Janë edhe ekipet monitorues, plani i konferencave, dhe se ky plan parasheh në detaje gjithçka që duhet...

Anëtarët e KQZ, me vota unanime e miratoi planin operacional.

**Shqyrtimi dhe miratimi plotësimeve të përbërjes së KVV-ve, për komunën e Leposaviqit dhe plotësimin me anëtar rezervë të KVV-ve për Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut:**

**Arianit Elshani**, tha se KOZ- i ka shqyrtuar një kërkesë të sekretariati për plotësim të përbërjes së KVV-e, dhe e ftoj krye shëfin ta shpjegojë këtë...

Burim Ahmetaj, tha se sekretariati ka edhe një "listë rezervë" të KVV-e, e cila nesër do të punojë dhe për plotësim të vendeve të paplotësuara. Kemi ndjekur procedurat e duhura, dhe lista përbëhet nga 48 anëtarë, dhe kërkojmë që kjo listë të miratohet..

Në këtë pikë, **Ilir Gashi**, tha se KVV-të janë miratuar, dhe cila ashtë tash arsyeja, a i plotësojnë kushtet, a janë verifikuar...

**Burim Ahmetaj**, tha se janë shfaqur disa dorëheqje, dhe ne po i plotësojmë, kemi bërë verifikimet sipas ligjit, dhe veprimet, të gjitha janë marrë..

Me vota unanime u miratua ky rekomandim.

Shqyrtimi dhe miratimi i Ekipeve Mobile për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut:

**Arianit Elshani**, e prezantoi këtë pikë dhe sipas nevojës, kemi rekomanduar formimin e 2 ekipeve mobile, dhe kërkojmë të miratohet kjo kërkesë...

Me vota unanime u miratua edhe ky rekomandim.

#### **4. Të ndryshme !**